

KAPITULLI I

KUSHTET TEKNIKE

Neni 1.

Menyra e zhvillimit të cdo veprimtarie kombetare apo nderkombetare që do të zhvillohet në vendin tone përcaktohet në bazë të Rregullores së zhvillimit të aktiviteteve, e cila hartohet dhe miratohet nga Kryesia e F.Sh.N. për cdo sezon sportiv.

- 1.1 Vendi, data, ora dhe menyra e zhvillimit të cdo veprimtarie përcaktohet në kalendarin sportive kombetar, në përputhje me strukturën organizative, të propozuara nga Komisioni Teknik në përkatësi me veprimtaritë nderkombetare dhe të miratuara nga kryesia e F.SH.N.
- 1.2 Kalendar kombetar dhe nderkombetar është i detyrueshëm të zbatohet nga të gjithë ekipet e notit që aderohet në F.SH.N. Ai mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtme:
 - a) Evenimente të jashtëzakonshme (epidemi, termet, përmbajtje, gjendje të jashtëzakonshme, mungesë të rendit publik, të sigurisë publike) të konfirmuara nga institucionet përkatëse.
 - b) Për aktivitetet miqësore nderkombetare, klubi sportive duhet të lajmërojë jo më vonë se dy javë përpara në F.SH.N. për datën e zhvillimit të aktivitetit miqësor nderkombetar, i cili mund të konfirmohet nga F.SH.N. vetëm nëqoftëse nuk ndikon në zhvillimin normal të aktivitetit sipas kalendarit sportiv.
- 1.3 Klubet sportive nuk kanë të drejtë të ndryshojnë orarin e aktivitetit të Kampionatit Kombetar pa miratimin e F.SH.N.
- 1.4 Të gjitha veprimtaritë kombetare zyrtare për të rritur (M+F) si Kampionati Kombetar, Kupa e Shqipërisë, etj, do të zhvillohen detyrimisht në pishinat sportive të miratuara nga F.SH.N.
- 1.5 Pishinat sportive të miratuara nga F.SH.N. për zhvillimin e veprimtarive kombetare të notit duhet të plotësojnë kushtet teknike dhe standartet për notim (pishinë 25m dhe 50m) sipas rregullores FINA, si edhe të garantojnë mbarevajtjen e aktivitetit.
- 1.6 Të gjithë veprimtaritë zyrtare që përfshihen në kalendarin kombetar zhvillohen detyrimisht në praninë e organeve të ruajtjes së rendit dhe të shërbimit mjekësor. Klubi prites (që organizon aktivitetin) duhet të marrë të gjitha masat organizative për të siguruar prezencën e tyre gjatë gjithë kohës së zhvillimit të aktivitetit.
- 1.7 Në të gjitha rastet kur kushtet e pishinës ose kushtet atmosferike bëjnë të pamundur teknikisht zhvillimin e aktivitetit, procedohet sipas rregullores teknike.
- 1.8

KAPITULLI II

Pjesëmarrja dhe aktivizimi i ekipeve dhe sportistëve.

Neni 2.

FEDERATA SHQIPTARE E NOTIT

Ne veprimtarite kombetare zyrtare te notit marrin pjese ekipet e licensuara te caktuara sipas strukture organizative, te miratuara nga kryesia e F.SH.N. ne perputhje me sezonin sportiv respektiv.

2.1 Per ekipet qe nuk do te pergjigjen sipas “nenit 2” do te merren masa ndeshkimore sipas akteve nenligjore te rregullores se brendshme te F.SH.N.

2.2 Sezoni sportiv perfshin te gjitha veprimtarite zyrtare kombetare dhe nderkombetare, ne perputhje me kalendarin sportive vjetor te aktiviteve, miratuar nga Kryesia e F.SH.N.

2.3 Ne aktivitetet kombetare dhe nderkombetare (zyrtare ose miqesore) aktivizohen trajnere, sportiste, dhe gjygtare me qendrim te mire moral. Per sportistin ose trajnerin qe mund te perjashtohen nga klubi perkates per thyerje te disiplines ose arsye te tjera duhet te njoftohet zyrtarisht F.SH.N.

2.4 Klubet sportive duhet te federojne jo me pak se 4 notare ne garat individuale me rezultate cilesore dhe normat perkatese per pjesmarrje ne aktivitetet e vitit kalendarik.

2.5 Sportistet duhet patjeter te jene te anetaresuar prane nje klubi apo shoqate sportive dhe nuk lejohen te aktivizohen brenda nje sezoni sportiv ne dy klube sportive, si brenda vendit ashtu dhe jashte tij (e vlefshme kjo per te gjitha kategorite e moshave).

2.6 Sportistet femije, te rinj e te reja mund te aktivizohen ne aktivitetet zyrtare me te rriturit, kampionat kombetar ose Kupa e Republikes,etj, pa e humbur te drejten e aktivizimit te tyre ne aktivitetet e moshave dhe te te rinjve.

2.7 Ne te gjitha veprimtarite kombetare brenda nje sezoni sportiv (viti kalendarik), moshat e sportisteve do te llogaritet vetem me vitin e lindjes (document identiteti), sipas federimit dhe licensimit te sportisteve ne fillim te sezonit sportiv.

2.8 Ne ekipet e femijeve marrin pjese sportiste deri ne moshen 14 vjec M+F, ne ekipet e te rinjve sportiste deri ne moshen 18 vjec M, dhe 16 vjec F dhe mbi kete moshe jane te rriturit.

2.9 Cdo klub apo shoqate sportive rregjistrohet me ane te formularit te rregjistrimit te aprovuar nga F.SH.N.. Formulari I rregjistrimit duhet te dorezohet per miratim ne F.SH.N. 15 (pesmbedhete) dite para fillimit te veprimtarise se pare sportive. Rregjistrimi behet kundrejt pagases sipas akteve nenligjore. Te gjitha klubet qe nuk bejne licensimin ne kohen e duhur, nuk lejohen te marrin pjese ne veprimtarine e pare kombetare te kalendarit vjetor te veprimtarive dhe gjobiten sipas akteve nenligjore.

2.9.1 Gjate veprimtarive kombetare dhe nderkombetare brenda nje sezoni sportive, nuk lejohet qe nje ekip te ndryshoje emrin e tij me te cilin eshte rregjistruar ne fillim te sezonit sportiv.

2.9.2 Cdo ekip pervec listes se federimit do te dergoje ne F.SH.N. licensimin per cdo trajner, zv.trajner dhe mjek. Per cdo license do te paguhet vlere e caktuar sipas akteve nenligjore. Periudha e miratimit te licensave eshte 15 dite para fillimit te veprimtarise se pare sportive. Per moskorrektese penalitetet do jene si ne paragrafin 2.9.

FEDERATA SHQIPTARE E NOTIT

2.9.3 Te gjithë notaret M+F të cilët nuk janë regjistruar në listat e federimit të ekipeve në fillim të sezonit sportiv, mund të regjistrohen me anë të “listës së federimit shtesë” në çdo kohë, në rast se notari plotëson kërkesat në përputhje me nenin 2.6.

2.9.4 Klubet sportive vëne në dispozicion të F.SH.N. trajnere, mjeke, gjyqtare dhe notare që ajo cakton për aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare zyrtare dhe miqësore, në përputhje me strukturën dhe programin e F.SH. të Notit.

2.9.5 Mosparaqitja e personave të mesipër sipas pikës 2.9.4 mund të justifikohet nga ana e tyre vetëm duke dërguar në F.SH.N. arsyet me shkrim. Pjesëmarrja ose mospjesëmarrja e tyre vendoset nga F.SH.N.

2.10 Gjate zhvillimit të veprimtarive kombëtare ose ndërkombëtare, zyrtare ose miqësore, të drejtën për të qëndruar pranë ekipit e kanë vetëm trajnerët, zv.trajnerët, si edhe mjeku i ekipit, të cilët janë të licensuar brenda të njëjtit ekip.

2.10.1 Në rast të mungesës së trajnereve në një aktivitet sportiv, ata mund të zëvendësohen nga trajnere ose zv.trajnere Brenda të njëjtit klub sportiv

2.11 Në të gjitha veprimtaritë kombëtare zyrtare, notaret e një ekipi duhet të paraqiten me uniformat e rregullta sportive (të një modeli dhe ngjyre).

2.11.1 Të gjithë sponsorët që duan të vendosin emrat e tyre në uniformat sportive të skuadrave gjate veprimtarive zyrtare, duhet të regjistrohen në F.SH.N. kundrejt takses sipas aktëve nenligjore.

2.12 Çdo ekip ka të drejtë të marrë he të aktivizojë notare të huaj me kontratë 1(një) vjeçare për një sezon sportiv, por jo më shumë se 2 (dy) notare për ekip.

2.12.1 Kontratat për transferimin e notareve Brenda vendit behen për notaret me moshe 15 vjeç e më të rritur M + F. Mosha përcaktohet sipas vitit të lindjes.

2.12.2 Transferimi i notareve brenda dhe jashtë vendit nga njëri klub në një klub tjetër sportiv behet vetëm me anë të “certifikatës së transferimit”. Të gjitha klubet që do të marrin notare në ekipet e tyre, duhet të marrin në FSHN formularin e gatshëm, kundrejt pagesës sipas aktëve nenligjore.

2.12.4 Procedura e transferimit fillon nga klubi që do të marrë notarin. Pas plotësimit të formularit të kushteve të transferimit, firmosjes nga ana e notarit, zyrtarizimit (firmë + vullnet) nga të dy klubet sportive, dhe pasi klubi sportiv që merr notarin shlyen detyrimin financiar kaqshë klubit tjetër, atëherë FSHN i jep notarit të drejtën e transferimit.

2.12.5 “Certifikata e transferimit” duhet të plotësohet në 4 (kater) kopje, një kopje FSHN, një kopje notarit, një kopje klubit që shet notarin dhe një kopje klubi që e blen.

2.13 Kontrata për transferimin e notareve behen jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para fillimit të veprimtarisë së parë sportive. Jashtë kësaj periudhe FSHN nuk kryen veprime për transferimin e notareve.

FEDERATA SHQIPTARE E NOTIT

2.14 Kontratat ndermjet dy klubeve sportive te vendit tone, per transferimin e notareve do te behen kundrejt pageses prej nje shume : 80.000 leke . Moshja percaktohet sipas vitit te lindjes.

2.14.1 shuma ne leke sipas paragrafit 2.14, ndahet 20% notar, 20% trajneri, dhe 60% klubi qe shet notarin.

2.14.2 Mbas procedurave te transferimit, FSHN nuk mban pergjegjesi per detyrimet ndermjet dy klubeve.

2.15 Klub origjine per nje notar quhet ai klub sportive me te cilin notary federohet, licensohet dhe aktivizohet per here te pare ne aktivitetet zyrtare te notit te organizuara nga FSHN.

2.16 Notari I transferuar nuk ka te drejte te kthehet dhe te aktivizohet me klubin e origjines Brenda te njejtis sezon.

2.16.1 Per transferimin e notareve si Brenda ashtu dhe jashte vendit, te drejten e transferimit e ka vetem klubi perkates, sipas procedurave te percaktuara nga FSHN dhe FINA.

2.17 FSHN leshon “certifikaten e transferimit” per jashte shtetit sipas modelit te F.I.N.A. mbi bazen e kerkeses se notarit dhe klubit te origjines. Klubi I origjines duhet te paraqese ne FSHN kontraten ndermjet dy klubeve respective per treansferimin e notarit jashte shtetit.

2.18 Kontrata duhet te depozitohet ne FSHN dhe duhet te permbaje:

a) Periudhen e kontraktimit

b) Notari I ekipit kombetar Brenda kesaj periudhe eshte I detyruar te aktivizohet me ekipin tone kombetar sa here q eta kerkoje FSHN per aktivitete nderkombetare zyrtare. Per shpenzimet e udhetimit do te pergjigjet FSHN.

c) Kontrata eshte e vlefshme kur eshte firmosur dhe vulosur nga klubi I origjines, klubi qe merr notarin, federate qe merr notarin dhe federate e origjines.

2.18.1 Ne perfundim te procedurave te transferimit, notary duhet te paguaje taksen ne FSHN, sipas akteve nenligjore te “Certifikates se transferimit”.

2.19 Kur nje klub I vendit tone do te marre nje nota rte nje shteti tjeter (me kontrate), pervec detyrimeve financiare qe ka kundrejt klubit te origjines ai eshte I detyruar te paguaje ne FSHN taksen e detyrueshme. Pa kete pagese notary nuk mund te aktivizohet me klubin marres.

2.20 Te gjithë ekipet e klubeve apo shoqerive sportive te vendit tone qe do te marrin pjese ne aktivitetet zyrtare nderkombetare, korrespondencen me FINA apo LEN do te bejne nepermjet FSHN.

2.20.1 Te gjithë ekipet e klubeve sportive te vendit tone qe do te marrin pjese ne aktivitetet zyrtare nderkombetare, do te konfirmojne me shkrim ne FSHN garancine e nivelit cilesor te rezultatit dhe garancine financiare Brenda nje afati kohor te percaktuar nga FSHN.

2,20.2 FSHN nuk mban pergjegjesi per sanksionet qe do te marre FINA apo LEN karshi ekipit apo notarit te cilet nuk I permbahen rregullores se aktivitetvenderkombetare ne te cilat marrin pjese.

2.21 Cdo klub dhe shoqate sportive qe do te marre pjese ne veprimtarite kombetare zyrtare te notit, duhet te paraqese ne FSHN dokumentacionin e plote sipas Statutit dhe rregullores se brendshme..

2.21.1 Nuk lejohet qe gjate veprimtarive kombetare zyrtare brenda te njejtit sezon sportiv, nje klub apo nje shoqate te perfaqesohet me te njejtin emer qe perfaqesohet nje klub sportive I qytetit.

2.22 Te gjitha organizatat, shoqatat dhe fondacionet me karakter bamires mund te marrin pjese ne veprimtarite kombetare zyrtare por nuk dote klasifikohen ne renditjen perfundimtare te ketyre veprimtarive.

K A P I T U L L I I I I

KLASIFIKIMI DHE STIMUJT

Neni 3. Ne veprimtarite kombetare zyrtare do te kete klasifikim per cdo kategori moshe:

- Te pergjithshem M-F vendi I – II – III
- Ekipore M-F vendi I – II – III
- Individuale M-F vendi I – II – III

3.1 Ne cdo veprimtari kombetare do te kete klasifikim individual per cdo kategori moshe e seksi, vendi I – II – III.

3.2 Stimujt do te jene per cdo kategori moshe e seksi, ekipore dhe individuale.

a) Per kampionatet kombetare te rritur (ekipore dhe individuale):
Vendi I-re = kupe, medalje, diploma.

Vendi II-te = medalje, diploma.

Vendi III-te = medalje, diploma.

b) Per Kupa e Shqiperise:

Vendi I-re = Kupe dhe diplome Vendi

II-te dhe III-te = diploma

c) Kampionati kombetar per te rinjte dhe femije:

Vendi I-re = kupe dhe diploma

Vendi II-te dhe III-te = diploma

d) Per gare individuale (notary me I mire I grupmoshes) : kupe dhe diplome.

3.3 K.E. I FSHN miraton per cdo sezon sportiv stimuj material dhe financiare per veprimtarite kombetare dhe nderkombetare per ekiye dhe individe per:

a) Kampionat kombetar per te rritur

b) Notaret qe thyejne rekordet per te rritur, te rinj dhe femije.

c) Notaret qe arrijne rezultate ne veprimtarite nderkombetare zyrtare.

3.4 Per takimet miqesore apo zyrtare, FSHN, klubet dhe shoqerite sportive japin per ekiye dhe individe te vecante:

a) Kupa + diploma.

b) Flamuj, emblem dhe stema te FSHN-se.

c) Dhurata dhe punime artizanale.

d) Vlere ne leke nga donator dhe sponsor.

K A P I T U L L I IV GJYGJTARIA

Neni 4.

Kolegjiumi Qendror I Gjygtarise ve ne dispozicion te FSHN , gjygtare te kat. I-re, te II-te dhe te III-te, per veprimtarite kombetare zyrtare.

4.1 Lista e federimit te gjygtareve plotesohet sipas kerkeses se FSHN nga kolegjiumi qendror I gjygtarise.

4.1.1 Lista e federimit te gjygtareve ne FSHN 15 dite para zhvillimit te veprimtarise se pare zyrtare te sezonit sportive. Ato duhet te jene te licensuar dhe te miratuar nga kolegjiumi qendror I gjygtarise dhe nga kryesia e FSHN.

4.2 Per drejtimin e takimeve zyrtare kombetare dhe nderkombetare, gjygtaret propozohen nga kolegjiumi qendror dhe miratohen nga Kryesia dhe Sekretari I FSHN.

4.3 Ne veprimtarita kombetare kryegjygtari caktohet nga kryesia e federates dhe miratohet nga sekretari I FSHN. Caktimi I gjygtareve per drejtimin e aktivitetit behet nga kryegjygtari dhe miratohen nga Sekretari I FSHN.

FEDERATA SHQIPTARE E NOTIT

- 4.4 FSHN cakton veshgues ne te gjitha veprimtarite kombetare, te cilet ushtrojne te drejten e kontrollit per zbatimin e rregullores se aktiviteve sportive.
- 4.5 Kryegjygtari, 1 ose 2 dite pas perfundimit te aktiviteve dergon ne FSHN relacionin mbi zhvillimin e veprimtarise , klasifikimin, protokollet, reklamimet, aktivizimin e notareve, trajnereve dhe gjygtareve.
- 4.6 Protokollet e garave duhet te plotesohen me kujdes dhe te jene te lexueshme duke respektuar te gjitha kerkesat teknike.
- 4.7 Gjygtaret duhet te paraqiten 30 minuta para fillimit te garave. Uniforma e tyre duhet te jete ngjyre e bardhe (ose njengjyreshe).
- 4.8 Gjygtaret nuk duhet te lejojne qe Brenda territorit te pishines te futen persona te tepert ne kundershtim me ato qe percakton rregullorja.
- 4.9 Klubet sportive nuk kane te drejte per asnje arsye dhe ne asnje rast te bejne zevendesimin e gjygtareve te caktuar nga kolegji qendror dhe miratuar nga FSHN me pare. Ata mund te bejne propozime dhe te presin miratimin e tyre nga FSHN.
- 4.10 Reklamimet mund te merren parasysh vetem kur ka shkelje te rregullores teknike dhe asaj te brendshme te FSHN. Ato I dorezohen kryegjygtarit dhe sekretarit te FSHN nga pergjegjesi I ekipit jo me vone se 15 minuta nga perfundimi I gares per te cilen behet reklamimi.
- 4.10.1 Pergjigjet per reklamimet do te jepen nga komisioni veshgues teknik dhe kryegjygtari I gares jo me vone se 15 minuta mbas perfundimit te veprimtarise se asaj dite.
- Per cdo reklamim te pabazuar, komisioni veshgues teknik propozon marrje masash disiplinore , ose pagese gjobe bazuar ne aktet n/ligjore.
- 4.11 Per gabimet ne protokollin e gares nuk pranohet asnje reklamim, por do te vashdohetn conform rregullores teknike, qe cdo gabim te ndreqet menjehere qe ne momentin e konstatimit.
- 4.12 Reklamimin e ben vetem pergjegjesi ose kryegjygtari. Kete document te firmosur nga kryegjygtari ia bashkangjit protokollit te gares.
- 4.13 Gjygtaret ne drejtimin e garave , mbesheten ne rregulloren teknike te notit si edhe ne te gjitha ndyshimet e bera dhe te derguara me shkrim nga FSHN.
- 4.14 E drejta per te gjykuar ne veprimtarite kombetare zyrtare mund te pezullohet per gjygtare te vecante ne keto raste:

a) Kur kolegji I gjygtareve te notit nuk dorezon ne FSHN listen e federimit te gjygtareve 15 dite para fillimit te veprimtarise se pare kombetare zyrtare. Gjygtari pezullohet per nje faze te sezonit sportiv dhe gjobitet sipas akteve n/ligjore.

b) Kur gjygtari paraqitet me vonese ne gare, denohet per dy gara pasardhese.

FEDERATA SHQIPTARE E NOTIT

c) Kur nuk paraqitet ne garen zyrtare I caktuar nga FSHN, denohet me mospjesmarrije ne 4 gara. Ne rast perseritje denohet per nje vit dhe gjobitet sipas akteve n/ligjore.

d) Kur pa arsye dhe pa vene ne dijeni kolegjiun e notit gjygtari largohet per nje periudhe 6 mujore, atehere ai automatikisht humbet te drejten e aktivizimit ne veprimtarite kombetare zyrtare te sezonit sportive. Kur mungon nje sezon sportive ai skualifikohet per 2 (dy) vjet.

e) Kur per gjykim te dobet, qe ndikon drejtperdrejt ne rezultatin perfundimtar te gares, gjygtari pezullohet 5 gara nga veprimtaria kombetare zyrtare.

f) Kur para ose mbas gares ul figuren e tij morale, pezullohet per dy vjet nga veprimtarite kombetare zyrtare.

g) Kur shkel rregulloren teknike dhe ate te brendshme, kur nuk zbaton detyrat e tij para dhe mbas gares. Kur paraqitet me uniforme jot e rregullt, kur lejon notare me uniforme qe bie ne kundershtrim me rregulloren, kur vonon informacionin, kur dergon me vonese ose humb protokollin e gares, pezullohet per 3 aktivitete.

4.15 Nje gjygtar I cdo kategorie qe kalon trajner prane nje klubi sportiv, nuk ka te drejte te aktivizohet per sa kohe qe eshte trajner.

K A P I T U L L I V

ORGANIZIMI I VEPRIMTARIVE NENI 5

Veprimtarite zyrtare ne nje sezon sportive do te jene:

- a) Kampionati kombetar per te rritur dhe veterane (M-F)
- b) Kupa e Shqiperise per te rritur (M-F)
- c) Kampinati kombetar per te rinj (M-F)
- d) Kampionati kombetar per femije (M-F)
- e) Maratona kombetare per te rritur, te rinj dhe femije (M-F)

5.1 Per strehimin e ekipeve ne baze te njotimeve zyrtare te derguara nga ekipet pjesmarrese, klubi sportive organizator jep informacion per akomodimin e ekipeve.

5.2 FSHN nuk pergjigjet per sigurimin e automjeteve te udhetimit per ekipet, gjygtaret dhe veshguesit.

FEDERATA SHQIPTARE E NOTIT

5.3 Ne fillim dhe ne mbarim te cdo veprimtarie do te zhvillohet ceremonia e hapjes dhe e mbylljes. Ekipet jane te detyruara te marrin pjese me te gjitha efektivin e tyre te rregjistruar ne protokollin e garave, si dhe te gjitha gjygtaret pjesmarres te asaj veprimtarie.

5.4 Per ceremonine e hapjes dhe te mbylljes ten je veprimtarie pergjigjet klubi organizator, ekipet pjesmarrese dhe FSHN.

5.5 30 minuta para fillimit te garave, gjygtaret duhet te kontrollojne dokumentacionin e ekipeve (listat e federimeve dhe licensat). Personat qe nuk jane te federuar ose nuk kane license, nuk kane te drejte te marrin pjese ne gare. Gjygtaret duhet te kontrollojne rregullsine e dokumentave (firmat dhe vulat perkatese), pastaj te japin konfirmimin per pjesmarrjen e tyre ne gare.

5.5.1 Licensat e ekipeve duhet te qendrojne ne tavolinene secretaries nga fillimi deri ne fund te gares.

5.6 Ne rast se ndonje notary ose trajneri I humb licensa, atehere drejtuesit e klubit sportiv duhet te njoftojne menjehere ne FSHN per zevendesimin e saj (sipas takses perkatese).

5.6.1 Ne rast te mos zevendesimit te licenses ne kohen e duhur, notari apo trajneri duhet te paraqiten ne gare me nje document identifikimi, pasaporte ose certificate. Ne kete rast trajneri dhe notary leshojne para gares nje deklarate ne pranine e gjygtarise duke marre pergjegjesine e konsequencave qe mund te rrjedhin nga verifikimi I plote I dokumentacionit nga institucioni zyrtar perkates. Te gjitha licensat duhet te jene me fotografine perkatese te personit dhe te miratuara nga FSHN.

5.7 Ne tavolinen e gjygtarit duhet te qendroje vetem gjygtari I gares. Asnje person tjetër nuk ka te drejte te ulet ne tavolinen e gjygtarit. Ne tavolinen e secretaries qendrojne sekretari dhe veshguesi.

5.8 Ne pishinat e denuara per crregullime te publikut, FSHN vendos per zhvillimin e garave ne keto pishina pa pranine e publikut. Lejohen te aktivizohen ne kete rast : ekipet, trajneret, pergjegjesit e klubeve, mjeke /masazhator, gjygtare dhe veshgues, si edhe organet e rendit public.

5.8.1 Ne rast se crregullimet do te vashdojne dhe do te ndikojne direct ne rezultatin perfundimtar te garave, atehere FSHN vendos per pezullimin e garave ne kete pishine dhe klubi vendas gjobitet sipas akteve nenligjore.

5.9 ne rastet kur ekipi paraqitet pa trajner dhe mungon edhe zv.trajneri, asnje person tjetër nuk ka te drejte te drejtoje ekipin. Te drejten ne kete rast e merr vetem kapiteni I ekipit.

5.10 Zv. Trajneri mund te drejtoje ekipin gjate nje gare ne rastet kur :

- Trajneri I pare largohet vullnetarisht nga gara.
- Trajneri I pare largohet per arsye te denimit nga gjygtaria.
- Trajneri I pare nuk paraqitet ne gare.

K A P I T U L L I VI
KATEGORIZIMI I TRAJNEREVE

Neni 6.

FSHN ka te drejte te jape kategorite perkatese te trajnerit te notit dhe per kete cdo trajner pajiset me licensen perkatese.

6.1 FSHN akordon kategorite ne baze te arsimit perkates, kualifikimit professional dhe nivelit cilesor te ekipit qe drejton, si me poshte:

- Trajner I kategorise kombetare
- Trajner I kategorise se pare
- Trajner I kategorise se dyte
- Trajner I kategorise se trete

6.2 Per ekipet e femijeve deri ne 14 vjec , konsiderohesh trajner I kategorise se trete.

6.3 Per ekipet e te rinjve deri ne moshen 18 vjec, dhe te rejave deri 16 vjec, konsiderohesh trajner I kategorise se dyte.

6.4 Per ekipet e te rriturve dhe te rriturave mbi moshen 18 vjec (M) dhe 16vjec (F), konsiderohesh trajner I kategorise se pare.

6.5 Per te gjitha moshat , kur perfaqesojne ekipet kombetare , konsiderohesh trajner I kategorise kombetare ose te pare.

6.6 Per cdo kategori , te drejten e licenses respective e jep vetem FSHN sipas nje programi te miratuar prej saj.

6.7 Cdo vit FSHN ne bashkepunim me komisionin teknik te FSHN organizon dhe zhvillon kurse per kategorizimin e trajnerëve. Komisioni Teknik I FSHN pregatit pyetsoret per licensimin e trajnerëve, si dhe ndjek te gjithë veprimtarine e kategorizimit te trajnerëve mbi bazen e aplikimeve te bera prej tyre (te gjithë trajneret duhet te kene paraqitur ne FSHN CV e tyre. Komisioni teknik vlereson trajneret mbi bazen e programeve te caktuara prej saj, duke dhene dhe kategorite perkatese. Kurset e kategorizimit te trajnerëve zhvillohen ne teori dhe ne praktike. Kohezgjatja e kurseve eshte ne verasi te programeve qe do te kryhen ne perputhje me kategorite e ndryshme.

6.8 Kurset I zhvillojne specialist trajnere, te cilet I propozon komisioni teknik I FSHN dhe I miraton kryesia e FSHN.

6.9 Vleresimin per cdo kandidat e ben komisioni I caktuar nga FSHN. Ky I fundit ia percjell dokumentacionin perkates komisionit teknik te federates. Ngritjen nga nje kategori ne tjetren e miraton KE I FSHN-se.

6.10 Licensat e trajnerev te kategorise se pare dhe te dyte duhet te rinovohen cdo 4 vjet mbi bazen e kualifikimit. Ato miratohen dhe firmosen nga Presidenti I FSHN dhe Sekretari I Pergjithshem. Dhenia ose ruajtja e kategorise se trajnerit behet me propozimin e komisionit teknik dhe miratim te KE se FSHN-se.

6.11 Per trajneret e kategorise kombetare, kerkesen e ben vete I interesuari; ate e shqyrton komisioni teknik I FSHN, I cili ja percjell kryesise se FSHN.

6.12 Licensen per trajnerin e kategorise kombetare e miraton dhe e firmos Presidenti I FSHN dhe Sekretari I Pergjithshem.

6.12.1 Licensa e trajnerit kombetar I jepet kur ai njeh dhe zoteron te gjithë programet e zhvillimit te notit, programet e te gjithë moshave, kur ai bashkepunon dhe eshte aktiv ne te gjithë detyrat me karakter teknik te caktuara nga FSHN.

6.12.2 Trajner kombetar nuk mund te akordohet pa patyr me pare licensen e trajnerit te kategorise se pare.

6.12.3 Titulli trajner kombetar nuk perben asnje funksion zyrtar te qendrueshem per mbajtesin, per arsye se ai eshte I detyruar te bashkepusoje dhe te plotesoje te gjithë detyrimet qe I ngarkon komisioni teknik I FSHN dhe kryesia e FSHN.

6.12.4 Titulli trajner kombetar mund te hiqet ne cdo moment nga kryesia e FSHN mbi bazen e propozimit te komisionit teknik te FSHN. Ne kete rast, licensa e trajnerit kombetar zevendesohet me licensen e trajnerit te kategorise se pare.

6.13 Shpenzimet qe nevojiten per zhvillimin e kurseve dhe seminareve te kualifikimit te trajnereve sigurohen nga sponsor dhe donator. Ato administrohen nga FSHN per te siguruar ambjentin dhe bazen material, si edhe pagesat e lektoreve e drejtuesve.

6.14 Cdo kandidat qe do te rregjistrohet ne kurset e kategorizimit eshte I detyruar te paguaje Shumen sipas akteve n/ligjore.

6.14.1 Te gjitha shpenzimet per udhetim, veshmbathje, fjetje, dhe ushqim I ka ne ngarkim kandidati.

6.15 Te gjithë kandidatet duhet te kalojne nga kategoria me e ulet deri ne kategorine e pare. Nuk mund te fitohet kategoria me e larte pa patur me pare kategorine me te ulet.

K A P I T U L L I V I I

KATEGORIZIMI I GJYGJTAREVE

Neni 7.

FSHN ka te drejte te jape kategorite perkatese te gjygtareve dhe te pajise cdo gjygtar me license sipas kategorise perkatese.

7.1 FSHN jep kategorite si me poshte:

- Gjygtar kombetar
- Gjygtar I kategorise se pare
- Gjygtar I kategorise se dyte
- Gjygtar I kategorise se trete.

7.1.1 Titulli gjygtar I kat. III-te, te II-te , te I-re dhe kombetar jepet me propozim te Kolegjiumit Qendror te Gjygtareve dhe me miratimin e Kryesise se FSHN. Gjygtaret qe fitojne titullin “Gjygtar nderkombetar” akorduar nga FINA , fitojne automatikisht titullin “Gjygtar kombetar”.

7.2 Pranimi per gjygtar I behet atij personi qe ka mbaruar detyrimisht shkollen e mesme. Prioritet do te kene gjygtaret femra.

7.3 FSHN merr persiper organizimin e kurseve per gjygtare te cilet kerkojne te fitojne kategorine e dyte, te pare dhe kombetare.

7.4 Kurset qe organizon FSHN I drejtojne gjygtaret me arsim dhe kategori te larte, te cilet do ti propozoje Kolegjiumi Qendror I Gjygtareve dhe do ti miratoje FSHN.

7.5 Vleresimi I cdo kandidati do te behet nga komisioni I caktuar nga Kolegjiumi Qendror I Gjygtareve dhe miratimi perfundimtar do te behet ne kryesine e FSHN.

7.6 Licensat per cdo gjygtar miratohen dhe firmosen nga Presidenti dhe Sekretari I Pergjithshem I FSHN.

7.7 FSHN mer ngarkim shpenzimet per organizimin e kursit, bazen material dhe pagesen e lektoreve dhe drejtuesve.

7.8 Cdo kandidat qe do te rregjistrohet ne kurset e kategorizimit eshte I detyruar te paguaje Shumen sipas akteve n/ligjore.

7.9 Shpenzimet per udhetimin, veshmbathjen, fjetjen, dhe ushqimin I perballon vete kandidati.

7.10 Te gjithë kandidatet duhet te kalojne nga kategoria me e ulet ne ate me te larte.

7.10.1 Nuk mund te fitohet kategoria me e larte pa patur me pare kategorine me te ulet.

7.11 Te drejten per te gjykuar e ka cdo gjygtar ne Republiken e Shqiperise me moshe deri 70 vjec. Gjygtaret nderkombetar dhe kandidatet nderkombetar me moshe deri 55 vjec.

K A P I T U L L I VIII
DOKUMENTACIONI

Neni 8.

8.1 Per anetaresimin e nje shoqate, shoqerie etj, pervec kushteve te dokumentacionit te parashikuara ne Nenin 4 te Statutit te FSHN, duhet qe Statusi i anetarit te kete objekt te veprimtarise vetem zhvillimin dhe ushtrimin e sportit te notit dhe te disiplinave te tjera ujore qe percaktohen ne statutin e FSHN, per te garantuar perputhjen e veprimtarise se subjektit (anetar i FSHN-se) me objektin, qellimet dhe strukturen e Federates se Notit. Një klub, shoqatë ose shoqëri sportive që është anëtare e Federatës Shqiptare të Notit nuk mund të jetë njëkohësisht anetare e nje federate tjeter sportive kombëtare për një disiplinë sportive të ndryshme nga noti. Kufizimi i parashikuar, zbatohet për statusin e anëtarësimit të subjektit dhe nuk pengon sportistët, trajnerët, gjyqtarët apo personelin tjetër të licencuar që të ushtrojnë, sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni dhe rregulloret përkatëse, veprimtari në disiplina të tjera sportive.

8.2 Lista e federimeve te ekipeve pjesmarrese ne veprimtarite kombetare pembajne keto te dhena., dhe te jene te firmosura e vulosura nga Drejtori i klubit /shoqates

- Emer, mbiemer
- Datelindja

8.3 Cdo sportist duhet te jete i pajisur me karteles mjekesore

8.4 Listat e federimit zyrtarizohen (firme, vule) nga Presidenti dhe Sekretari ekzekutiv I klubit.

8.5 Ne listat e federimit shenohen vetem trajneret te cilet miratohen nga FSHN per te drejtuar ekipin ne gare.

8.6 Listat e federimit te gjygtareve pjesmarres ne veprimtarita kombetare do te perfshijne gjygtaret e kat. I-re, II-te, III-te dhe te jene te miratuara nga FSHN.

8.7 Lista e federimit te gjygtareve do te firmoset nga cdo gjygtar, kryetari I kolegjiut qendror dhe miratohet nga FSHN.

8.8 Klubi sportive duhet te kete dokumentacionin e meposhtem:

Statutin dhe rregilloren e brendshme te FSHN.

Rregulloren teknike te FSHN.

Rregulloren e zhvillimit te aktiviteteve te sezonit sportive.

Buletine, literature te vendit dhe te huaj, si dhe material rreth notit.

Te gjithë korespondencen me FSHN.

8.9 Trajneret duhet tekene dokumentacionin e meposhtem:

Programin e stëvitjes se ekipit.

Planin perspektiv disa vjecar

Kolegjiut e gjygtareve duhet te kene dokumentacionin qe permban rregulloren teknike, te brendshme , te gjithë ndryshimet perkatese te bera ne keto rregullore si dhe udhezimet e deguara me shkrim nga FSHN.

K A P I T U L L I IX

EKIPET KOMBETARE

Neni 9. Ekip kombetar quhet skuadra e zgjedhur nga FSHN dhe e autorizuar qe te perfaqesojë Shqiperine ne te gjitha veprimtarite kombetare.

Neni 9.1 Ekipet kombetare qe kane te drejte te perfaqesojne Shqiperine jane:

-Ekipi kombetar I te rriturve M + F

-Ekipi kombetar I te rinjve M + F

-Ekipi kombetar I femijeve M + F

-Ekipi kombetar I veteraneve.

9.2 Ekipet kombetare kene te drejten e trajnimit te diferencuar gjate periudhes se pregatitjes, para veprimtarise kombetare.

9.3 Trajneret e ekipeve kombetare propozohen nga Komisioni Teknik I FSHN dhe miratohen nga kryesia e FSHN. Ata do te zgjidhen ne baze te experiences dhe rezultateve te tyre ne aktivitetet e notit ne baze te programeve stervitore qe do te paraqesin dhe do te testohen per aftesite e tyre teorike – praktike. Ata do te testohen gjithashtu mbi shkallen e njohjes se rregullores teknike dhe asaj nderkombetare te notit.

9.3.1 Notaret apo trajneret qe thirren nga FSHN ne ekipin kombetar duhet te kene konfirmimin zyrtar nga klubet e tyre sportive.

9.4 Te gjithë notaret e ekipeve kombetare duhet te kene nenshtetesine shqiptare. Ne ekipet kombetare mund te marrin pjese dhe notare te huaj te natyralizuar, menjehere pasi ata kane marre dokumentin e nenshtetesise dhe te mos jene anetare te ndonje ekipi tjeter kombetar.

9.5 Notaret e ekipeve kombetare do te zgjidhen duke pasur parasysh nenshtetesine, moshen, seksin, gjendjen shendetsore, seleksionimin dhe testimin e tyre. Notaret e ekipeve kombetare do te zgjidhen duke pasur parasysh nenshtetesine, moshen, seksin, gjendjen shendetsore, seleksionimin dhe testimin e tyre. Per Sportistet shqiptare qe jetojne jashte vendit, per te qene pjese e ekipeve kombetare qe mbeshteten financiarisht nga FSHN, KOKSH, FINA, LEN, duhet te kene qene pjese e aktiviteve kombetare te vitit kalendarik te meparshem ose te kete arritur normat kualifikuese te eventit nderkombetar te radhes. Sportisti duhet te anetaresohet prane nje klubi apo shoqate sportive nepermjet te cilit te shkembeje informacione."